



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I MINISTRAVE

**AKT NORMATIV**

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_

**PËR**

**PËRBALLIMIN E PASOJAVE TË FATKEQËSISË NATYRORE**

Në mbështetje të nenit 101 të Kushtetutës, me propozimin e ministrit të Brendshëm, ministrit të Financave dhe Ekonomisë, ministrit të Mbrojtjes, dhe ministrit të Drejtësisë, Këshilli i Ministrave

**V E N D O S I:**

**KREU I  
TË PËRGJITHSHME**

**Neni 1  
Objekti**

Ky akt rregullon funksionimin e organeve përgjegjëse për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe të territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësi të tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja, duke përcaktuar detyrat dhe përgjegjësitë e tyre, programet e procesit të rindërtimit, funksionimin e fondit të rindërtimit dhe procedurat përkatëse.

**Neni 2  
Qëllimi**

Ky akt ka për qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore që ndodhin në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe të fatkeqësive të tjera që, për shkak të intensitetit, të shkallës dhe të shtrirjes së tyre, kërkojnë ndërhyrje të menjëhershme të të gjitha institucioneve të mbrojtjes civile dhe të autoriteteve të tjera shtetërore dhe për të cilat shpallet gjendja e fatkeqësisë në përputhje me parashikimet e legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile.

### Neni 3 Fusha e zbatimit

1. Dispozitat e këtij akti zbatohen për verifikimin dhe rregullimin e pasojave të gjendjes së fatkeqësisë natyrore dhe të fatkeqësive të tjera, që shpallet në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile.
2. Autoritetet përgjegjëse të përcaktuara në këtë akt dhe organet e tjera shtetërore kryejnë procedurat për zbatimin e programeve në lidhje me rregullimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore dhe të fatkeqësive të tjera, sipas përcaktimeve të këtij akti dhe legjislacionit në fuqi për situatat e emergjencës.

### Neni 4 Përkufizimet

Në kuptim të këtij akti, me termat e mëposhtëm nënkuptojmë:

1. “**Banesë**”, një ndërtesë ose një njësi banimi brenda një ndërtese që përbëhet nga bashkësia e mjediseve ose mjedisi i vetëm që ka hyrje të pavarur dhe dalje në kat, oborr, tarracë ose rrugë e destinuar për banim.
2. “**Donacion**”, akti i ofrimit të mjeteve financiare ose i kontributeve në natyrë në mënyrë vullnetare nga donatorët.
3. “**Donatorë**”, janë individët, personat fizikë dhe juridikë, vendas apo të huaj, qeveritë e shteteve të huaja, institucionet bankare dhe institucionet financiare jobankare, organizatat jofitimprurëse, vendase dhe të huaja, organizmat ndërkombëtarë, që kontribuojnë në mjete financiare ose në natyrë, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas parashikimeve të këtij akti.
4. “**Familje**”, konsiderohen individët që rezultojnë në përbërjen familjare sipas të dhënave në regjistrin e gjendjes civile përkatëse.
5. “**Fatkeqësi natyrore**” dhe “**Fatkeqësi tjetër**”, kanë të njëjtin kuptim sipas ligjit nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”. Kur në këtë akt përdoren fjalët fatkeqësi natyrore, parashikimet përkatëse zbatohen njësoj dhe për fatkeqësinë tjetër.
6. “**Gjendja e fatkeqësisë natyrore**”, është gjendja e vendosur nga Këshilli i Ministrave, në përputhje me Kushtetutën dhe legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile, në një pjesë ose në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, për parandalimin ose mënjanimin e pasojave të një fatkeqësie natyrore ose të fatkeqësive të tjera.
7. “**Marrëveshje kuadër**”, marrëveshja që lidhet me operatorët ekonomikë, në përfundim të fazës së parë kualifikuese, për secilën procedurë prokurimi publik të procesit të rindërtimit, sipas parashikimeve të këtij akti.

8. **“Njësi zbatuese”**, një ose disa organe publike të ngarkuara nga Këshilli i Ministrave për administrimin e fondeve të transferuara nga fondi i rindërtimit, si dhe për kryerjen e detyrave të tjera të parashikuara në këtë ligj.
9. **“Prokurimi publik për rindërtimin”**, procesi i përshpejtuar i prokurimit që zbatojnë autoritetet kontraktore për përzgjedhjen e fituesve për kontratat publike për mallra, punë dhe shërbime, në kuadër të zbatimit të procesit të rindërtimit, në përputhje me parashikimet e këtij akti dhe të ligjit për prokurimin publik, për aq sa nuk bie në kundërshtim me parashikimet e këtij akti.
10. **“Plan i detyruar vendor”**, dokument planifikimi që hartojnë njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet përgjegjëse, sipas rastit, për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore dhe, kur çmohet e nevojshme, për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit, që përcakton kushtet për zhvillim të detyruar si dhe zhvillimin e zonave të reja.
11. **“Prishje e detyruar”**, procesi i shembjes së një ndërtese apo disa ndërtesave, në pronësi private apo publike, të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, që përbëjnë rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve dhe që nuk mund të riparohen, siç vërtetohet nga aktekspertiza e thelluar.
12. **“Ndërtesë e dëmtuar”**, çdo ndërtesë, në pronësi publike apo private, e dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, që përbën rrezik për jetën e shëndetin e njerëzve dhe që nuk mund të riparohet.
13. **“Zonë e dëmtuar”**, territori që përfshin një ose disa ndërtesa, infrastruktura publike apo edhe infrastrukturë kritike të dëmtuar.
14. **“Aktekspertizë e thelluar”**, është akti që lëshon çdo person fizik ose juridik, subjekt i së drejtës tregtare, i pajisur me lejen, licencën ose autorizimin përkatës nga autoritetet shtetërore për vërtetimin e gjendjes së rrezikut për jetën dhe shëndetin, nga ndërtesa apo grupi i ndërtesave të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, si dhe ku rekomandohen masat që duhen marrë sipas parashikimeve në këtë ligj.
15. **“Infrastrukturë publike”**, janë ndërtesat në pronësi publike si dhe rrugët, sheshet, parqet apo hapësira të ngjashme publike, të ndryshme nga infrastruktura kritike.
16. **“Infrastrukturë kritike”**, janë strukturat fizike, rrjetet dhe pasuritë e tjera, të cilat janë të domosdoshme për funksionimin ekonomik e social të shoqërisë ose të komunitetit, sipas përcaktimeve në ligjin nr.45/2019, “Për mbrojtjen civile”.
17. **“Zhvillim i detyruar”**, e drejta e autoritetit përgjegjës për të vendosur prishjen e ndërtesave dhe zhvillimin e territorit ku ndodhen ndërtesa apo një grup ndërtesash, në pronësi publike apo private, si rezultat i dëmtimit të tyre nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore dhe që rrezikon jetën e shëndetin e banorëve, si dhe për zhvillimin e zonës së re në përputhje me planin e detyruar vendor, sipas parashikimeve të këtij akti.
18. **“Zonë e re për zhvillim”**, territori që përcaktohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe shpallet me vendim të Këshillit të Ministrave, si zonë e përshtatshme për zhvillimin e detyruar, sipas kushteve dhe kriterëve të përcaktuara në këtë ligj.

## **Neni 5**

### **Subjektet përfituese**

1. Subjekte përfituese janë individët dhe familjet, që kanë humbur një ose më shumë anëtarë të familjes dhe/ose kanë pësuar dëme në banesat e tyre dhe kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe institucionet publike që kanë pësuar dëme në ndërtesat apo infrastrukturën publike në pronësi apo në administrim të tyre, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore.
2. Tregtarët ose shoqëritë tregtare, të cilëve si pasojë e fatkeqësisë natyrore i është dëmtuar selia e tyre ose çdo vend i ushtrimit të aktivitetit tregtar, në pronësi të tyre, në njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, përveç kur është parashikuar ndryshe në këtë ligj, mund të përfitojnë vetëm nga programi i masave për rimëkëmbjen ekonomike, sipas parashikimeve të këtij akti.
3. Nuk është subjekt përfitues individi ose familja që ka në pronësi ose posedim të ligjshëm, më shumë se një banesë, në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, pavarësisht nëse banesa që është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore ka qenë vendbanimi i zakonshëm. Në rast se të gjitha banesat në pronësi ose në posedim janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, individi ose familja përfiton, sipas parashikimeve të këtij akti, vetëm për banesën që në datën e fatkeqësisë natyrore përdorej si vendbanim i zakonshëm. Nëse pas përfitimit, sipas kësaj pike, banesa ose banesat e tjera të familjes përfshihen në planin e detyruar vendor, përfitimi i sipërfaqeve në ndërtimet e reja do të kryhet sipas parashikimeve të këtij akti.
4. Individët dhe familjet, banesa e të cilëve është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, por që nga autoritetet përgjegjëse është vlerësuar si e banueshme, nëse nuk kanë përfituar nga ndonjë program tjetër i procesit të rindërtimit, përfitojnë kompensimin e dëmeve, sipas parashikimeve të këtij akti.
5. Subjektet që kanë pësuar dëme në ndërtesa, jashtë territorit ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë, në rastet kur provohet se dëmet janë pasojë e fatkeqësisë natyrore përfitojnë kompensimin e dëmeve sipas parashikimeve të këtij akti.
6. Nuk janë subjekte përfituese subjektet e së drejtës tregtare në fushën e ndërtimit për ndërtesat ose njësitë brenda një ndërtese në pronësi të tyre, që janë dëmtuar nga fatkeqësia natyrore, kur dëmi ka ardhur si rrjedhojë e gabimeve në projektimin apo ndërtimin e ndërtesës kryer prej vetë subjektit

ndërtues që është njëkohësisht dhe pronar i objektit, përveç rastit kur zbatohet zhvillimi i detyruar vendor sipas parashikimeve të këtij akti.

## **KREU II**

### **PARIMET E PËRGJITHSHME TË RINDËRTIMIT**

#### **Neni 6**

#### **Përmirësimi i kushteve të jetesës dhe shëndetit**

1. Rimëkëmbja nga gjendja e fatkeqësisë natyrore ka si qëllim, për aq sa është e mundur, garantimin e kthimit në kushte optimale jetese dhe funksionimi të komuniteteve të prekura nga fatkeqësitë natyrore si dhe forcimin e aftësisë së këtyre komuniteteve për t'i bërë ballë gjendjeve të fatkeqësive natyrore në të ardhmen.
2. Autoritetet publike dhe subjektet private përgjatë procesit të rindërtimit janë të detyruara të garantojnë përdorimin e kushteve dhe teknikave që parandalojnë rreziqet e fatkeqësive natyrore në të ardhmen në përputhje me konceptin “rindërto më mirë”.

#### **Neni 7**

#### **Parimi i zhvillimit të qendrueshëm**

Autoritetet publike përgjatë procesit të rindërtimit marrin në konsideratë që përballimi i pasojave të fatkeqësisë natyrore të plotësojë, për aq sa është e mundur, jo vetëm nevojat e qytetarëve për përmirësimin e kushteve të jetesës dhe të shëndetit, por njëkohësisht të mos ndikojë në aftësinë e brezave të ardhshëm për të përmbushur nevojat e tyre.

#### **Neni 8**

#### **Parimi i strehimit të përshtatshëm**

1. Strehimi i përshtatshëm për një individ ose familje konsiderohet strehimi që garanton privatësi, një jetesë të sigurt, të qetë dhe me dinjitet.
2. Strehimi është i përshtatshëm nëse plotëson kushtet e mëposhtme:
  - a) Hapësira të mjaftueshme banimi sipas normave të strehimit dhe standardeve të ndërtimit, sipas përcaktimit të legjislacionit në fuqi;
  - b) Shërbimet bazë, brenda mjedisit të banimit;
  - c) Qëndrueshmëri dhe siguri nga rreziqe që burojnë nga veprimet ose mosveprimet njerëzore, faktorët natyrorë e klimaterikë;
  - ç) Qasje në shërbimet publike, si furnizimi me ujë të pijshëm dhe energji elektrike, largimi i ujërave të ndotura dhe menaxhimi i mbetjeve;

- d) Akses në shërbimet e punësimit, shërbimet e kujdesit shëndetësor dhe social, në arsim dhe në shërbime të tjera komunitare.

### **Neni 9**

#### **Parimi i trajtimit të barabartë të shtetasve**

1. E drejta për të përfituar dhe për të marrë pjesë në programet e procesit të rindërtimit u garantohet subjekteve të këtij akti pa diskriminim në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër.
2. Programet e procesit të rindërtimit mund të parashikojnë kritere ose raste të posaçme për t'i ardhur në ndihmë individëve, familjeve ose grupeve në nevojë apo kategorive të veçanta.

### **Neni 10**

#### **Parimi i informimit dhe transparencës**

Autoritetet publike bëjnë publike çdo të ardhur, donacion apo shpenzim që kryhet me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore.

### **Neni 11**

#### **Parimi i kontrollit dhe përgjegjshmërisë në përdorimin e fondeve**

Çdo aktivitet ose shpenzim i kryer për realizimin e qëllimit të këtij akti normativ i nënshtrohet kontrollit të ligjshmërisë, auditimit financiar dhe të performancës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

## **KREU III**

### **AUTORITETET PËRGJEGJËSE PËR PËRBALLIMIN E PASOJAVE TË FATKEQËSISË NATYRORE**

### **Neni 12**

#### **Autoritetet përgjegjëse**

Autoritetet përgjegjëse për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore janë:

- a) Këshilli i Ministrave;
- b) Komisioni Shtetëror i Rindërtimit;

- c) Ministri përgjegjës në fushën e përgjegjësisë të të cilit, përfshihet përballimi i pasojave nga fatkeqësia natyrore dhe fatkeqësi të tjera;
- ç) Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile;
- ç) Njësitë zbatuese;
- d) Njësitë e vetëqeverisjes vendore.

### **Neni 13** **Këshilli i Ministrave**

Këshilli i Ministrave miraton:

- a) politikat për përballimin dhe rregullimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore dhe fatkeqësive të tjera.
- b) propozimet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit për:
  - i. përdorimin e fondit të rindërtimit nga njësitë zbatuese dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, për qëllimet dhe sipas parashikimeve të përcaktuara në këtë akt normativ;
  - ii. programin e përgjithshëm të rindërtimit;
  - iii. përcaktimin e njësive zbatuese për projektet në kuadër të procesit të rindërtimit;
  - iv. shpalljen e zonave të reja për zhvillim në përputhje me parashikimet e e këtij akti.
- c) kushtet, kriteret, fondin financiar dhe rregullat për përdorimin e tij, organet përgjegjëse dhe procedurat për përballimin e pasojave të veçanta të fatkeqësisë natyrore;
- ç) shpenzimet operative dhe koordinuese për mirëfunksionimin e fondit të rindërtimit;
- d) çdo vendim në lidhje me çështje të tjera në funksion të zbatimit të këtij akti normativ.

### **Neni 14** **Komisioni Shtetëror i Rindërtimit**

1. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit krijohet nga Këshilli i Ministrave.
2. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit është organi përgjegjës për propozimin e programit të përgjithshëm të rindërtimit dhe bashkërendimin e veprimeve të institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, si dhe të burimeve materiale e financiare për rehabilitimin dhe rindërtimin e komuniteteve dhe territoreve të prekura nga fatkeqësitë natyrore ose fatkeqësitë e tjera, si dhe zhvillimin e territoreve të reja.

3. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit mund të kontraktojë ekspertë gjatë hartimit të programit të përgjithshëm të rindërtimit nëpërmjet procedurave të prokurimit të parashikuara në kreun VI, të këtij akti.
4. Komisioni Shtetëror i Rindërtimit ushtron këto kompetenca:
  - a) Harton dhe i propozon Këshillit të Ministrave programin e përgjithshëm të rindërtimit;
  - b) Bashkërendon veprimtarinë e institucioneve shtetërore dhe të subjekteve private, përfshirë dhe donatorët, në përputhje me programin e përgjithshëm të rindërtimit si dhe me procesin e rindërtimit;
  - c) Në konsultim me njësitë e vetëqeverisjes vendore i propozon Këshillit të Ministrave shpalljen e zonave të reja për zhvillim;
  - ç) Siguron informimin e publikut dhe transparencën mbi procesin e rindërtimit.
5. Programi i përgjithshëm i rindërtimit përmban të paktën të dhëna për:
  - a) personat që kanë humbur jetën nga fatkeqësia;
  - b) familjet e mbetura të pastreha ose të dëmtuara, të renditura sipas kriterëve të përparësisë që parashikohen në këtë ligj;
  - c) ndërtesat e dëmtuara dhe të rrezikuara, të ndara në publike dhe private;
  - ç) kushtet dhe kriteret e përfitimit në përputhje me programet e procesit të rindërtimit, sipas parashikimeve të këtij akti;
  - d) objektet e infrastrukturës publike dhe kritike, si dhe veprat e trashëgimisë kulturore, zonat e mbrojtura dhe burimet natyrore të dëmtuara nga fatkeqësia natyrore;
  - dh) vlerën e dëmeve të shkaktuara, për aq sa është e mundur;
  - e) masat që rekomandohen të merren në kuadër të programeve të procesit të rindërtimit dhe buxhetet e përfaqëta, nëse ka.
6. Përbërja, organizimi, veprimtaria dhe rregullat e funksionimit të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit caktohen me vendim të Këshillit të Ministrave, në varësi të llojit të fatkeqësisë dhe masave të nevojshme për përballimin e pasojave të ardhurave nga fatkeqësia natyrore.
7. Gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, Komiteti Ndërmintor i Emergjencave Civile ushtron funksionet e Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, në rast se Komisioni nuk është ngritur nga Këshilli i Ministrave.

**Neni 15**  
**Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile**

1. Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile (AKMC) mbledh, menaxhon, përpunon dhe analizon të gjitha aktet e vlerësimit paraprak, aktekspertizat e thelluara dhe çdo të dhënë tjetër mbi pasojat e fatkeqësisë natyrore apo

fatkeqësive të tjera, që i përcillen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet e tjera shtetërore.

2. AKMC-ja edhe kryesisht mund verifikojë aktet e vlerësimit paraprak, aktekspertizat e thelluara si dhe të dhënat e tjera të përcjella nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet e tjera shtetërore, si dhe mund të kërkojë informacione shtesë mbi këto të dhëna nga njësitë e vetëqeverisjes vendore apo autoritetet e tjera shtetërore ose drejtpërdrejt nga subjektet e interesuara.
3. AKMC-ja vepron si sekretariat teknik i Komisionit Shtetëror të Rindërtimit dhe mbështet Komisionin për përmbushjen e detyrave të parashikuara nga ky akt normativ.

## **Neni 16**

### **Njësitë zbatuese**

1. Njësia zbatuese administron fondet që transferohen nga Këshilli i Ministrave prej fondit të rindërtimit, përfshi dhe kontributet në natyrë, dhe është përgjegjëse për zhvillimin e procedurave të prokurimit, sipas parashikimeve të këtij akti normativ për:
  - a) studimin dhe planifikimin e territoreve për rehabilitim dhe/ose rindërtim si dhe zonave të reja për zhvillim;
  - b) ndërtimin e banesave të reja ose të ndërtesave publike të dëmtuara;
  - c) rikonstrukcionin e banesave ose të ndërtesave publike të deklaruara të pabanueshme;
  - ç) ndërtimin dhe rikonstrukcionin e infrastrukturës publike e kritike, sipas parashikimeve të këtij akti;
  - d) punimet e rikonstrukcionit, rehabilitimit dhe ndërtimit në monumentet e trashëgimisë kulturore;
  - dh) realizimin e ndërtimeve në zonat e reja për zhvillim;
  - e) çdo ndërhyrje tjetër në funksion të rindërtimit të territoreve të prekura nga fatkeqësia.
2. Njësia zbatuese bashkëvepron me të gjitha institucionet publike përgjegjëse, sipas fushës së përgjegjësisë, të cilat kanë detyrimin të përmbushin kërkesat e njësisë zbatuese për informacion ose vendosjen në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm, jo më vonë se 15 ditë nga data e marrjes së kërkesës.
3. Njësia zbatuese cakohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Në çdo rast, Këshilli i Ministrave mund të caktojë më shumë se një njësi zbatuese, duke pasur në konsideratë tiparet e veçanta dhe volumet e programet të procesit të rindërtimit si dhe nevojën për përmbushjen e funksioneve nga struktura të specializuara.

## **Neni 17**

### **Njësitë e vetëqeverisjes vendore**

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, në zbatim të kompetencave të tyre sipas përcaktimeve në legjislacionin në fuqi për mbrojtjen civile dhe për planifikimin dhe zhvillimin e territorit:
  - a) administrojnë fondet që transferohen nga Këshilli i Ministrave prej fondit të rindërtimit, përfshi dhe kontributet në natyrë, kur caktohen si njësi zbatuese me vendim të Këshillit të Ministrave, sipas rregullave e procedurave të parashikuara në këtë akt normativ;
  - b) miratojnë planet e detyruara vendore, planet e detajuara vendore dhe lejet e zhvillimit e të ndërtimit, në funksion të procesit të rindërtimit, sipas rregullave dhe procedurave të parashikuara në këtë akt normativ;
  - c) krijojnë, administrojnë dhe përditësojnë bazën e të dhënave për individët dhe familjet që kanë humbur familjarë dhe/ose kanë mbetur të pastrehë si pasojë e fatkeqësisë natyrore, si dhe plotësimin e nevojave të tyre nga programet e procesit të rindërtimit.
2. Me qëllim mirëmenaxhimit e procesit të rindërtimit në nivel lokal, mund të krijojnë zyra të posaçme për rindërtimin. Njësia e vetëqeverisjes vendore merr masat përkatëse për të siguruar funksionimin e plotë të zyrës së posaçme, nëpërmjet caktimit të personelit të përshtatshëm për përmbushjen e funksioneve të saj.
3. Zyra e posaçme funksionon si njësi ndihmëse dhe menaxhimi operacional për njësinë e vetëqeverisjes vendore dhe kryen detyrat e mëposhtme:
  - a) Lehtëson përgatitjen dhe ndjekjen e procedurave për planifikimin e detyruar vendor, dhënien e lejeve të nevojshme për ndërtimin, rikonstruksionin dhe riparimin si dhe lëshimin e akteve të përdorimit të ndërtesave, shtëpive individuale private, ndërtesave dhe infrastrukturës publike e kritike, që ndërtohen në kuadër të procesit të rindërtimit.
  - b) Bashkërendon me organet e tjera, në nivel vendor dhe qendror, në funksion të realizimit të procesit të rindërtimit;
  - c) Kryen të gjitha detyrat e tjera të përcaktuara me këtë akt ose me vendim të organeve të vetëqeverisjes vendore.
4. Njësia e vetëqeverisjes vendore bashkëvepron me njësitë zbatuese, Entin Kombëtar të Banësive, Autoritetin Rrugor Shqiptar, Operatorin e Shpërndarjes së Energjisë Elektrike, Operatorin e Sistemit të Transmetimit, ministritë e linjës si dhe me çdo institucion tjetër publik përgjegjës.

## **KREU IV**

### **PROCESI I RINDËRTIMIT**

## **Neni 18**

### **Procesi i rindërtimit dhe programet e tij**

1. Procesi i rindërtimit është një proces i integruar zhvillimi i përbërë nga disa programe, në funksion të përmirësimit të kushteve të jetesës dhe të shëndetit pas shpalljes së gjendjes së fatkeqësisë natyrore, që përcaktohen në këtë nen.
2. Programi i zhvillimit të objekteve të reja që përbëhet nga këto nënprograme:
  - a) Zhvillimi i objekteve të reja dhe i zonave të reja për zhvillim, përfshirë infrastrukturën publike përkatëse si dhe rikonstrukcioni i ndërtesave ekzistuese të dëmtuara dhe të infrastrukturës publike nga autoritetet shtetërore;
  - b) Zhvillimi i objekteve të reja dhe zonave të reja për zhvillim, përfshirë infrastrukturën publike përkatëse si dhe rikonstrukcioni i ndërtesave ekzistuese të dëmtuara dhe të infrastrukturës publike, nga autoritetet shtetërore nga donatorët;
  - c) Rindërtimi i ndërtesave të shembura nga fatkeqësia natyrore në të njëjtin truall;
  - ç) Programi i bashkëpunimit për ndërtime në bashkëpunim me sektorin privat.
3. Programi i ndërtimit të infrastrukturës publike kur nuk është pjesë e programeve të tjera të parashikuara në këtë ligj, dhe të infrastrukturës kritike është programi me anë të të cilit me financim nga fondi i rindërtimit apo nga donatorët ndërtohen ose rikonstruktohen objekte të infrastrukturës publike dhe kritike nga njësitë zbatuese.
4. Programi i krijimit të fondit të banesave përbëhet nga:
  - a) programi i blerjes së banesave të reja në treg të lirë;
  - b) programi i banesave të dhuruara nga subjektet private.
5. Programi i granteve të rindërtimit përbëhet nga:
  - a) granti për rindërtimin ose rikonstrukcionin e banesave të dëmtuara;
  - b) pagesa e qirasë për familjet e mbetura të pastreha nga fatkeqësia natyrore;
  - c) kompensimi i shpenzimeve të subjekteve të sektorit privat që ofrojnë struktura akomoduese për familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore.
6. Programi i masave të rimëkëmbjes sociale dhe ekonomike që përbëhet nga këto nënprograme:
  - a) Kompensimi i dëmeve nga fatkeqësia natyrore;
  - b) Masat për rimëkëmbjen sociale;
  - c) Masat për rimëkëmbjen ekonomike;

ç) Masat rikuperuese dhe parandaluese.

7. Kushtet, kriteret, kategoritë prioritare, procedurat dhe rregullat për vlerësimin dhe përzgjedhjen e përfituesve nga programet e procesit të rindërtimit, përfshirë dhe autoritetet përgjegjëse shtetërore, përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Përfituesit nuk mund të përfitojnë në të njëjtën kohë nga më shumë se një program i procesit të rindërtimit për qëllime strehimi, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë akt. Autoritetet përgjegjëse marrin masa që subjektet të cilat nuk përfitojnë nga një program i caktuar, të kenë mundësi për të kaluar në një program tjetër të procesit të rindërtimit, sipas kushteve dhe procedurave të parashikuara në vendimin e Këshillit të Ministrave. Subjektet përfituese nga programet e procesit të rindërtimit konsiderohen që shpërblehen, jo më shumë se vlera e dëmit real të përbërë nga humbja e pësuar e jetës së njeriut dhe/ose vlera e dëmeve pasurore.

8. Kriteret e përparësisë për renditjen e përfituesve janë:

- a) familjet që kanë humbur familjarët nga fatkeqësia natyrore;
- b) familjet njëprindërore që kanë në ngarkim fëmijë, ku përfshihen edhe vajzat nëna;
- c) familjet që kanë në përbërje personat me aftësi të kufizuara;
- ç) të moshuarit, që kanë mbushur moshën e pensionit;
- d) familjet në skemën e ndihmës ekonomike;
- dh) të rënë në krye të detyrës.

## **SEKSIONI I**

### **PROGRAMI I ZHVILLIMIT TË OBJEKTEVE DHE ZONAVE TË REJA**

#### **Neni 19**

#### **Zhvillimi i objekteve dhe/ose zonave të reja dhe i infrastrukturës publike nga autoritetet shtetërore**

1. Nëpërmjet fondit të rindërtimit ndërtohen ose rikonstruktohen objekte dhe zhvillohen zona të reja, sipas parashikimeve të këtij akti normativ. Parashikimet në këtë nen zbatohen njësoj, për aq sa është e mundur, si për ndërtimin e objekteve të reja dhe zhvillimin e zonave të reja, ashtu dhe për rikonstrukcionin e objekteve ekzistuese.
2. Njësitë e vetëqeverisjeve vendore identifikojnë zonat për qëllim ndërtimi të objekteve të reja dhe/ose infrastrukturës publike dhe zonat e reja dhe planifikojnë zhvillimin e tyre sipas dokumenteve të planifikimit të detyruar vendor dhe të parashikimeve në këtë akt normativ.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet përgjegjëse shtetërore për planifikimin dhe zhvillimin e territorit marrin masa për të hartuar planet e

detyruara vendore me procedura të përshpejtuara që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

4. Njësitë zbatuese kryejnë procedurat që parashikohen në këtë akt normativ për ndërtimin e objekteve ose infrastrukturave publike si dhe të zhvillimit të zonave të reja për zhvillim, sipas planifikimit të detyruar vendor.
5. Ndërtimet pa leje në zonat e reja për zhvillim dhe/ose në zonat e planifikuara për ndërtim sipas këtij akti, përjashtohen nga procedurat e legalizimit dhe subjektet poseduese të ndërtimeve pa leje trajtohen sipas parashikimeve të këtij akti, në përputhje me parimin e strehimit të përshtatshëm.
6. Pronarët privatë të trojeve që përfshihen në zonat e planifikuara për ndërtim ose në zonat e reja për zhvillim, mbi të cilat janë ngritur ose jo ndërtime pa leje, shpronësohen sipas parashikimeve të legjislacionit për shpronësimin ose përfitojnë sipërfaqe në ndërtimin e ri, sipas kushteve dhe procedurave që parashikohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në rast se pronari i truallit është dhe poseduesi i ndërtimit pa leje trajtohet dhe sipas parashikimeve të pikës 5, të këtij neni.
7. Për ndërtimet në zonat e reja për zhvillim në territor rural, pronarët e ligjshëm të pasurive të paluajtshme që përdoren për banim në zonat rurale zhvendosen për banim në zonat e reja për zhvillim. Në këto raste, pronarët privatë që zhvendosen ruajnë të drejtat e pronësisë për tokën. Kushtet dhe kriteret e përfitimit në objektet e reja rregullohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Të drejtat e pronarëve privatë të tokës në zonën e re për zhvillim në territor rural rregullohen, për aq sa munden, sipas parashikimeve të pikës 6, të këtij neni. Për nevoja të ekonomisë bujqësore, pronarëve privatë, prona e të cilëve është planifikuar si zonë e re për zhvillim, u jepet në pronësi tokë sipas parashikimeve me vendim të Këshillit të Ministrave.
8. Për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe lejeve të ndërtimit për objektet e reja dhe infrastrukturën publike zbatohen procedura të përshpejtuara që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
9. Me përfundimin e ndërtimit të objekteve të reja, njësia zbatuese, përgatit listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të njësive të banimit dhe shërbimit, nëse ka, dhe ia përcjell Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave me vendim i kalon objektet e reja në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose autoritetit përgjegjës shtetëror.
10. Njësia e vetëqeverisjes vendore apo autoriteti përgjegjës shtetëror kryen procedurat e kalimit të pronësisë si njësi individuale tek përfituesit sipas parashikimeve të këtij akti, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së dhurimit. Këshilli i Ministrave miraton formatin tip të kontratës së dhurimit, që përmban, përveç të tjerave, dhe detyrimin e përfituesit për heqje dorë, në

favor të shtetit ose të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në këmbim të banesës së re, nga e drejta e pronësisë mbi banesën e dëmtuar dhe truallin përkatës, nëse ka, ose nga e drejta e pronësisë së truallit për pronarin që trajtohet sipas shpronësimit me shkëmbim të sipërfaqes ndërtimore në objektin e ri.

11. Regjistrimi i kalimit të pronësisë së njësive të banimit te përfituesit kryhet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në emër të pronarit të pronës së dëmtuar ose të pronarit të pronës së shfrytëzuar për zhvillim. Për poseduesit e ndërtimeve pa leje, regjistrimi i njësive të banimit kryhet në emër të aplikuesit për legalizim të ndërtimit pa leje ose, në rast të mungesës së aplikimit, në emër të të gjithë familjarëve madhorë në momentin e regjistrimit të kontratës së dhurimit.
12. Subjektet përfituese të prekura nga fatkeqësia natyrore që kanë përparësi për strehim në objektet e reja sipas parashikimeve të këtij akti, përcaktohen në pikën 8, të nenit 18, të këtij akti. Lista e subjekteve përfituese hartohet nga njësiti e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse, që zbatojnë, për aq sa munden, dhe pa rënë ndesh me parashikimet e këtij akti, rregullat dhe procedurat për pikëzimin e kandidatëve që parashikohen në legjislacionin për strehimin social. Përfitimi sipas këtij nënprogrami nuk kushtëzohet nga aplikimi për përfitim dhe as nga niveli i të ardhurave të individit apo familjes. Njësia e vetëqeverisjes vendore harton dhe miraton listën mbi bazën e të dhënave për individët dhe familjet e pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore që administrojnë.
13. Në rast se pas plotësimit të nevojave për strehim të subjekteve përfituese nga ky akt, ka njësi banimi të lira, ato administrohen nga njësiti e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse, me qëllim plotësimin e nevojave për strehim, në përputhje me parashikimet e ligjit për strehimin social. Njësiti e shërbimit në objektet e reja, nëse ka, mbeten në pronësi dhe përdoren për nevoja të funksioneve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore ose të autoritetit përgjegjës shtetëror.

## **Neni 20**

### **Zhvillimi i objekteve dhe/ose zonave të reja dhe infrastrukturës publike nga donatorët**

1. Njëpërmjet investimeve të donatorëve ndërtohen ose rikonstruktohen objekte dhe zhvillohen zona e reja, sipas parashikimeve të këtij akti. Parashikimet në këtë nen zbatohen njësoj, për aq sa është e mundur, si për ndërtimin e objekteve të reja dhe zhvillimin e zonave të reja, ashtu dhe për rikonstrukcionin e objekteve ekzistuese.
2. Në rastet kur donatori kontribuon duke marrë përsipër ndërtimin ose rikonstrukcionin e objekteve të reja apo të infrastrukturave publike apo

zhvillimin e zonës së re për zhvillim, ndërmjet Këshillit të Ministrave dhe donatorit nënshkruhet marrëveshja e bashkëpunimit.

3. Në këto raste, njësitë e qeverisjes vendore marrin masa për të vënë në dispozicion të donatorit sheshin e ndërtimit dhe, sipas rastit, edhe projektin e ndërtimit.
4. Donatori përfiton të gjitha lehtësirat e nevojshme dhe përjashtimet tatimore që parashikohen në këtë akt apo në legjislacionin fiskal në fuqi, për ndërtimin e objekteve të reja dhe të infrastrukturës publike nga autoritetet shtetërore.
5. Në përfundim të realizimit të projektit, donatori përgatit listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të projektit të realizuar dhe ia percjell Këshillit të Ministrave.
6. Këshilli i Ministrave, me vendim, i kalon objektet e reja në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose autoritetit përgjegjës shtetëror.
7. Rregullat dhe procedurat parashikura në nenin 18, të këtij akti, vlejnë dhe zbatohen për aq sa është e mundur, edhe për ndërtimet e parashikuara në këtë nen.

### **Neni 21**

#### **Rindërtimi i objekteve të shembuara nga fatkeqësia natyrore në të njëjtin truall**

1. Me financim nga fondi i rindërtimit apo me investime nga donatorët ndërtohen ose rikonstruktohen ndërtesat e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, në truallin ekzistues, sipas parashikimeve të këtij akti.
2. Përfitues të njësisë të banimit në objektet e reja janë pronarët e njësisë të banimit të objekteve të shembura, në trojet e të cilave ndërtohen objektet e reja. Struktura e njësisë së banimit që i kalohet përfituesve nuk duhet të jetë më e madhe se struktura e njësisë së banimit që përfituesi kishte në pronësi në objektin e shembur. Rregulla për trajtimin e mospërputhjeve midis sipërfaqeve dhe strukturës së njësisë së banimit përcaktohen me udhëzim të ministrit që mbulon strehimin.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe autoritetet përgjegjëse shtetërore për planifikimin dhe zhvillimin e territorit marrin masa për të hartuar planet e detyruara vendore, me procedurë të përshpejtuar, që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
4. Njësitë zbatuese kryejnë procedurat që parashikohen në këtë akt për ndërtimin e objekteve ose infrastrukturave publike, sipas planifikimit të detyruar vendor.

5. Për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe të lejeve të ndërtimit, për objektet e reja zbatohen procedura të përshpejtuara që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe ndërtimit, në kuadër të planifikimit të detyruar nuk është i detyrueshëm miratimi i bashkëpronarëve të truallit që janë njëkohësisht përfitues nga nënprogrami që parashikohet në këtë nen.
6. Me përfundimin e ndërtimit të objekteve të reja, njësia zbatuese, përgatit listën e inventarit dhe dokumentacionin përkatës të njësive të banimit dhe shërbimit, nëse ka, dhe ia përcjell Këshillit të Ministrave. Këshilli i Ministrave me vendim i kalon objektet e reja në pronësi të njësisë së vetëqeverisjes vendore ose të autoritetit përgjegjës shtetëror.
7. Njësia e vetëqeverisjes vendore apo autoriteti përgjegjës shtetëror kryen procedurat e kalimit të pronësisë si njësi individuale të përfituesit, sipas parashikimeve të këtij akti, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës përkatëse. Këshilli i Ministrave miraton formatin tip të kontratës.
8. Regjistrimi i kalimit të pronësisë së njësive të banimit të përfituesit kryhet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në emër të pronarit të pronës së dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.
9. Në rast se, pas plotësimit të nevojave për strehim të subjekteve përfituese, sipas këtij neni, ka njësi banimi të lira, ato përdoren për subjekte të tjera përfituese, sipas parashikimeve të këtij akti dhe zbatohen, për aq sa është e mundur, rregullat dhe procedurat e parashikuara në nenin 19, të këtij akti. Në çdo rast, njësitë e shërbimit në objektet e reja, nëse ka, mbeten në pronësi dhe përdoren për nevoja të funksioneve administrative të njësive të vetëqeverisjes vendore ose të autoritetit përgjegjës shtetëror.
10. Pronarët e banesave të shembura mund të zgjedhin të ndërtojnë ndërtesa në të njëjtin truall, me një zhvillues privat, sipas kushteve të përcaktuara në marrëveshjen midis tyre. Nëse nuk është arritur një marrëveshje brenda 3 muajve nga dita e aktit që përcakton shembjen e objektit, zhvillimi i pronës do të bëhet nga autoriteti shtetëror ose donatotrë, sipas parashikimit të këtij neni. Nëse zhvilluesit e pronave janë persona, fizikë apo juridikë, në kushtet që parashikohen në pikat 3, 4 dhe 5, të nenit 42, të këtij akti, ata përjashtohen nga procesi i ndërtimit të këtyre banesave.
11. Për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe të lejeve të ndërtimit për objektet e reja sipas pikës 10, të këtij neni, zbatohen procedura të përshpejtuara që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në këto raste, zhvilluesi/investitori nuk përjashtohet nga taksat dhe tatimet e zbatueshme, sipas legjislacionit në fuqi dhe nuk përfiton përjashtimet fiskale, sipas parashikimeve të këtij akti.

## Neni 22

### Bashkëpunimi për ndërtime me sektorin privat

1. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, për qëllime të strehimit të familjeve të prekura nga fatkeqësia natyrore, vendosin troje në pronësi të tyre në dispozicion të zhvilluesve privatë përkundrejt përfitimit të sipërfaqeve ndërtimore në objektet e reja. Në këto raste, financimi i investimit të ndërtimit realizohet nga investitori privat dhe njësitë e vetëqeverisjes vendore përfiton në këmbim një përqindje të caktuar sipërfaqe ndërtimi, që llogaritet sipas kushteve dhe vlerës së tregut në këto marrëdhënie për të njëjtën zonë zhvillimi.
2. Kushtet, kriteret dhe procedurat e përzgjedhjes së investitorit bëhen në bazë të parimit të konkurrueshmërisë dhe parashikohen me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
3. Ndërmjet zhvilluesit dhe njësisë së vetëqeverisjes vendore nënshkruhet kontrata përkatëse ku përcaktohen të drejtat dhe detyrimet e palëve.
4. Për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe të lejeve të ndërtimit për objektet e reja zbatohen procedurat të përshpejtuara që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Në këto raste, zhvilluesi/investitori nuk përjashtohet nga taksat dhe tatimet e zbatueshme, sipas legjislacionit në fuqi dhe nuk përfiton përjashtimet fiskale, sipas parashikimeve të këtij akti.
5. Me përfundimin e ndërtimit të objekteve të reja, njësitë e vetëqeverisjes vendore kryen procedurat përkatëse të marrjes në dorëzim dhe të regjistrimit në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës të njësive të banimit dhe të shërbimit në objektet e reja.
6. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryen procedurat e kalimit të pronësisë si njësi individuale të përfituesit, sipas parashikimeve të këtij akti, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës përkatëse.
7. Subjektet përfituese të prekura nga fatkeqësia natyrore, që kanë përparësi për strehim në objektet e reja, sipas parashikimeve të këtij akti, përcaktohen në pikën 8, të nenit 18, të këtij akti. Lista e subjekteve përfituese hartohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, që zbatojnë, për aq sa munden, dhe pa rënë ndesh me parashikimet e këtij akti, rregullat dhe procedurat për pikëzimin e kandidatëve që parashikohen në legjislacionin për strehimin social. Përfitimi, sipas këtij nënprogrami nuk kushtëzohet nga aplikimi për përfitim dhe as nga niveli i të ardhurave të individit apo familjes. Njësitë e vetëqeverisjes vendore harton dhe miraton listën mbi bazën e të dhënave për individët dhe familjet e pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore që administrojnë.

8. Regjistrimi i kalimit të pronësisë së njësive të banimit të përfituesit kryhet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në emër të pronarit të pronës së dëmtuar prej fatkeqësisë natyrore. Në rast se pas plotësimit të nevojave për strehim të subjekteve përfituese të këtij akti, ka njësi banimi të lira, ato administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore, me qëllim plotësimin e nevojave për strehim në përputhje me parashikimet e ligjit për strehimin social.

## **SEKSIONI II**

### **Neni 23**

#### **Ndërtimi dhe rikonstrukcioni i infrastrukturës publike dhe kritike**

1. Me financim nga fondi i rindërtimit ndërtohen ose rikonstruktohen objekte publike, infrastruktura publike dhe kritike.
2. Njësia zbatuese, në kuptim të këtij neni, caktohet me vendim të Këshillit të Ministrave. Njësia zbatuese mund të jenë dhe subjektet juridike që administrojnë infrastrukturën kritike, të cilat, në varësi të mundësive, mund dhe të bashkëfinancojnë projektet e ndërtimit apo të rikonstrukcionit të objekteve të infrastrukturës kritike. Në çdo rast, pronësia e objektit të ri regjistrohet në Agjencinë Shtetërore të Kadastrës, në favor të shtetit ose të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
3. Në rast se ndërtimi ose rikonstrukcioni i objektit publik, i infrastrukturës publike dhe kritike, kryhet me financime nga donatorët, që realizojnë vetë dhe punimet e ndërtimit, lidhet marrëveshje bashkëpunimi me Këshillin e Ministrave.
4. Për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe të lejeve të ndërtimit për objekte publike, infrastruktura publike dhe kritike, zbatohen procedura të përsheptuara që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave. Ndërtimi dhe rikonstrukcioni i objekteve publike, i infrastrukturave publike dhe kritike, përjashtohen nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifatat e aplikimit të zbatueshme për lejet e ndërtimit.

## **SEKSIONI III**

### **PROGRAMI I KRIJIMIT TË FONDIT TË BANESAVE**

#### **Neni 24**

#### **Fondi i banesave të përballimit të fatkeqësive natyrore**

1. Për nevoja të strehimit të familjeve të prekura nga fatkeqësia natyrore, Enti Kombëtar i Banesave, sipas përcaktimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave dhe/ose njësitë e vetëqeverisjes vendore, krijon fondin e banesave të nevojshme për përballimin e pasojave të fatkeqësive natyrore, që

konsiston në banesat e blera me fonde nga fondi i rindërtimit në tregun e lirë si dhe nga banesat e dhuruara nga subjektet e treta në favor të shtetit, me qëllim përballimin e fatkeqësive natyrore.

2. Enti Kombëtar i Banesave ose njësitë e vetëqeverisjes vendore blejnë banesa në tregun e lirë, në rast se vlera e banesës në treg është më e ulët ose e barabartë me koston e ndërtimit. Banesa mund të blihet nga tregu, përjashtimisht, kur vlera e banesës në treg është më e lartë se kostoja e ndërtimit, vetëm kur:
  - a) vërtetohen kushte emergjente për strehimin e subjekteve përfituese, sipas këtij akti; ose
  - b) autoritetet shtetërore janë në pamundësi për të plotësuar nevojat për strehim të subjekteve përfituese, sipas parashikimeve të këtij akti.
3. Subjektet përfituese, të prekura nga fatkeqësia natyrore, që kanë përparësi për strehim në banesat e blera të mobiluara në treg të lirë, përcaktohen në pikën 8, të nenit 18, të këtij akti. Lista e subjekteve përfituese hartohet nga Enti Kombëtar i Banesave ose njësitë e vetëqeverisjes vendore, që zbatojnë, për aq sa munden dhe pa rënë ndesh me parashikimet e këtij akti, rregullat dhe procedurat për pikëzimin e kandidatëve që parashikohen në legjislacionin për strehimin social. Përfitimi sipas këtij nënprogrami nuk kushtëzohet nga aplikimi për përfitim dhe as nga niveli i të ardhurave të individit apo familjes. Njësia e vetëqeverisjes vendore harton dhe miraton listën mbi bazën e të dhënave për individët dhe familjet e pastreha si pasojë e fatkeqësisë natyrore që administron. Enti Kombëtar i Banesave harton listën e përfituesve sipas parashikimeve në vendimin e Këshillit të Ministrave.
4. Për blerjen e banesave të mobiluara nuk zbatohet legjislacioni për prokurimin publik. Autoritetet përgjegjëse vlerësojnë për blerjet çmimet mesatare të tregut të lirë, duke përzgjedhur në bazë të çmimit të favorshëm dhe të cilësisë së kërkuar, në ftesën për ofertë që i dërgojnë subjekteve tregtare të tregut të lirë. Autoritetet përgjegjëse marrin masa për të organizuar procedura transparente për blerjet që parashikohen në këtë nen.
5. Banesat e blera duhet të jenë të regjistruara në regjistrin publik të pasurive të paluajtshme, të lira nga çdo barrë dhe hipotekë. Nëse pronari apo bashkëpronarët e banesave që kërkohen të blihen janë persona fizikë apo juridikë, në kushtet që parashikohen në pikat 3, 4 dhe 5, të nenit 42, të këtij akti, ata përjashtohen nga procesi i blerjes së banesave.
6. Njësia e vetëqeverisjes vendore apo Enti Kombëtar i Banesave kryen procedurat e kalimit të pronësisë të banesave të përfituesit, sipas parashikimeve të këtij neni, nëpërmjet nënshkrimit të kontratës së dhurimit. Kontrata e dhurimit hartohet nga njësia e vetëqeverisjes vendore apo Enti Kombëtar i Banesave, sipas parashikimeve të Kodit Civil dhe përmban,

përveç të tjerave, dhe detyrimin e përfituesit për heqje dorë nga e drejta e pronësisë mbi banesën e dëmtuar dhe truallin përkatës, nëse ka, në favor të shtetit ose të njësisë së vetëqeverisjes vendore, në këmbim të banesës së re. Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të pajisë me banesë, sipas parashikimeve të këtij akti, dhe individë ose familje që nuk janë banorë të territorit të vet, por që rezultojnë subjekte përfituese në territorin e një njësie tjetër të vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, bazuar mbi një kërkesë të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.

7. Regjistrimi i kalimit të pronësisë së banesave të përfituesit kryhet nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, në emër të pronarit të pronës së dëmtuar nga fatkeqësia natyrore.
8. Kur lista e përfituesve me përparësi shteron dhe kanë mbetur banesa të lira, shpërndarja e tyre kalon sipas renditjes së përfituesve, kryer nga autoritetet përgjegjëse, sipas parashikimeve të këtij akti.
9. Në rast se pas plotësimit të nevojave për strehim, sipas parashikimeve të pikës 8, të këtij neni, ka njësi banimi të lira, ato administrohen nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose Enti Kombëtar i Banësive, me qëllim plotësimin e nevojave për strehim, në përputhje me parashikimet e ligjit për strehimin social.
10. Enti Kombëtar i Banësive është autoriteti përgjegjës për marrjen në dorëzim të banësive të tregut të lirë që dhurohen nga subjektet private. Rregullat e parashikura në pikat më sipër, vlejnë dhe zbatohen, për aq sa është e mundur, edhe për nënprogramin e banësive që dhurohen sipas parashikimeve të këtij neni. Dhurimi i njihet subjekteve juridike si shpenzim i zbritshëm dhe sponsorizim, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi.

## **SEKSIONI IV PROGRAMI I GRANTEVE TË RINDËRTIMIT**

### **Neni 25**

#### **Grantet për rindërtimin e banesës**

1. Përfitojnë grante ndërtimi ose rikonstruksioni, sipas projekteve model, familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, shtëpitë e banimit individuale të të cilëve janë klasifikuar si objekt i dëmtuar ose i pabanueshëm. Rregulla për projektet model, masa e përfitimit, kushtet, kriteret, procedurat dhe autoritetet përgjegjëse për vlerësimin e kërkesave dhe shpërndarjen e grantit parashikohen me vendim të Këshillit të Ministrave.
2. Për miratimin e lejeve të zhvillimit dhe të lejeve të ndërtimit, për rastet që parashikohen në pikën 1, të këtij neni, zbatohen procedura të përshpejtuara që miratohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

3. Ndërtimi dhe rikonstruksioni i banesave përjashtohet nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe tarifatat e aplikimit të zbatueshme për lejet e ndërtimit.

## **Neni 26** **Pagesa e qirasë**

1. Familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, të mbetura të pastreha pasi banesat ose shtëpitë e banimit individuale të tyre janë klasifikuar si objekt i dëmtuar ose i pabanueshëm, përfitojnë një pagesë qiraje në vlerën mesatare të tregut të lirë, për një vit, që miratohet me vendim të organeve të njësive të vetëqeverisjes vendore.
2. Për përfitimin e pagesës së qirasë, subjektet përfituese aplikojnë pranë njësisë së vetëqeverisjes vendore ku kanë vendbanimin, duke dorëzuar dokumentacionin, si më poshtë vijon:
  - a) Formularin e aplikimit sipas formati të miratuar nga njësia e vetëqeverisjes vendore;
  - b) Aktkonstatimin e Institutit të Ndërtimit;
  - c) Certifikatën familjare;
  - ç) Numrin e llogarisë në një bankë të nivelit të dytë.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore kryejnë procedurat e përshpejtuara për shqyrtimin e aplikimeve dhe miratimin përkatës të subjekteve përfituese dhe të nivelit të qirasë me vendim të këshillit të njësisë së vetëqeverisjes vendore.
4. Pagesa e qirasë, pas kalimit të afatit të parashikuar në pikën 1, të këtij neni, mund të miratohet deri në përfitimin e banesës së re nga autoritetet përgjegjëse shtetërore ose deri në përfundimin e ndërtimit apo të rikonstruksionit të banesës, në zbatim të programeve të procesit të rindërtimit të parashikuara në këtë ligj, nëse përfituesi plotëson kriteret dhe dokumentacionin përkatës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për strehimin social.
5. Shpenzimet e qirasë përballohen nga fondi i rindërtimit si dhe nga të ardhurat e njësive të vetëqeverisjes vendore.
6. Njësia e vetëqeverisjes vendore mund të miratojë qiranë e banesës, sipas parashikimeve të këtij neni, dhe për familje që nuk janë banorë të territorit të vet por që rezultojnë subjekte përfituese në territorin e një njësie tjetër të vetëqeverisjes vendore ku është shpallur gjendja e fatkeqësisë natyrore, bazuar mbi një kërkesë të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit, në kushtet e mungesës së mundësive për strehim në njësinë e vetëqeverisjes vendore ku ka vendbanimin përfituesi.

## **Neni 27**

### **Kompensimi i shpenzimeve për akomodim dhe ushqim**

1. Subjekte të sektorit privat ose institucione publike, që ofrojnë struktura akomoduese dhe shërbime për familjet e dëmtuara nga fatkeqësia natyrore, përfitojnë kompensim për shpenzimet e kryera për të gjithë periudhën e ofrimit të shërbimit.
2. Kriteret, kushtet, masa e shpenzimit që kompensohet, procedurat përkatëse dhe autoritetet përgjegjëse përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

## **SEKSIONI V**

### **PROGRAMI I MASAVE TË RIMËKËMBJES SOCIALE DHE EKONOMIKE**

## **Neni 28**

### **Kompensimi i dëmeve nga fatkeqësia natyrore**

Personat fizikë dhe juridikë që kanë pësuar dëm në banesat apo pronat e tyre, që nuk sjellin si nevojë rindërtimin apo riparimin e banesave dhe objekteve, sipas përcaktimeve të këtij akti, dhe që nuk kanë mbetur të pastrehë, përfitojnë kompensimin sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për mbrojtjen civile, vetëm nëse nuk kanë përfituar nga ndonjë program tjetër i procesit të rindërtimit, të parashikuar në këtë akt.

## **Neni 29**

### **Masa për rimëkëmbjen sociale**

1. Rimëkëmbja sociale përfshin masat për:
  - a) riaftësimin për punë të të prekurve nga fatkeqësia natyrore dhe mbështetjen për punësim, sipas programeve të aftësimin profesional dhe shërbimeve të punësimit sipas legjislacionit në fuqi, që ofrohen me përparësi për këtë kategori;
  - b) aksesin e plotë në shërbimet e kujdesit shëndetësor, social, në arsim, kulturë e shërbime të tjera komunitare, veçanërisht për ato familje që kanë ndryshuar vendbanim si pasojë e fatkeqësisë natyrore.
2. Brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij akti, ministritë e linjës hartojnë dhe zbatojnë programet sociale, të cilat miratohen me udhëzim ministri dhe bëhen pjesë përbërëse e programit të përgjithshëm të rindërtimit.

## **Neni 30**

## **Masa për rimëkëmbjen ekonomike**

1. Me qëllim favorizimin e rimëkëmbjes në sektorin e turizmit, të tregtisë, zejeve, agroturizmit, blegtorisë dhe bujqësisë, sektorin e prodhimit, ngrihet skema e mbështetjes së rimëkëmbjes financiare të zonave të prekura nga fatkeqësia.
2. Skema e mbështetjes së rimëkëmbjes ekonomike përfshin, midis të tjerave:
  - a) dhënien e përfitimeve të papunësisë për punëmarrës që kanë mbetur të papunë për shkak të shëmbjes ose të dëmtimit të vendit të punës ose për shkak të zhvendosjes, si pasojë e fatkeqësisë natyrore, e vërtetuar me dokumente zyrtare;
  - b) mbështetjen financiare të shoqërive tregtare, të vogla dhe të mesme, vendet e kryerjes së aktivitetit të të cilave janë dëmtuar dhe/ose zhvendosur për shkak të fatkeqësisë natyrore, vërtetuar me dokumente zyrtare, me qëllim rikonstruksionin e shpejtë ose sigurimin e mjediseve të përshtashme për kryerjen e veprimtarisë nga punëmarrësit.
3. Njësitë e vetëqeverisjes vendore marrin masa për të mbështetur sektorin privat, me qëllim rimëkëmbjen ekonomike sipas mundësive të veta buxhetore ose duke kërkuar financim për projekte të caktuara nga fondi i rindërtimit.
4. Kushtet, kriteret dhe procedurat për hartimin dhe zbatimin e masave të rimëkëmbjes ekonomike përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 31**

#### **Masa rikuperuese dhe parandaluese**

1. Përveç sa parashikohet në këtë ligj, ministritë përgjegjëse sipas fushës së tyre të përgjegjësisë marrin masa mbrojtëse, parandaluese dhe mbarëvajtjeje, si më poshtë vijon:
  - a) Ministria përgjegjëse për mjedisin identifikon dëmtimet e mjedisit nga fatkeqësia natyrore dhe harton planin e masave për rikuperimin, mbrojtjen dhe parandalimin e dëmeve eventuale si dhe kryen buxhetimin e tyre;
  - b) Ministria përgjegjëse për turizmin identifikon ndikimin e fatkeqësisë natyrore në turizëm dhe harton planin e masave për rikuperimin përkatës dhe zhvillimin e sektorit turistik;
  - c) Ministria përgjegjëse e infrastrukturës identifikon dëmtimet në zonat me burime natyrore nga fatkeqësia natyrore dhe harton planin e masave për rikuperimin, mbrojtjen dhe parandalimin e dëmeve eventuale si dhe kryen buxhetimin e tyre;

- c) Ministria përgjegjëse për kulturën identifikon dëmtimet në objektet dhe zonat e trashëgimisë kulturore nga fatkeqësia natyrore dhe harton planin e masave për rikuperimin, mbrojtjen dhe parandalimin e dëmeve eventuale si dhe kryen buxhetimin e tyre.
  - d) Ministria përgjegjëse për arsimin identifikon ndikimin e fatkeqësisë natyrore në procesin mësimor dhe harton planet e rikuperimit dhe mbarëvajtjes së procesit mësimor, sipas programeve përkatëse për vitin përkatës shkollor.
2. Planet e masave që parashikohen në këtë nen hartohen nga ministritë përgjegjëse brenda një muaji nga hyrja në fuqi e këtij akti dhe miratohen me udhëzim të ministrit përgjegjës dhe bëhen pjesë përbërëse e programit të përgjithshëm të rindërtimit.
  3. Këshilli i Ministrave, me kërkesë të ministrisë përgjegjëse, mund të vendosë financimin e një ose disa masave nga fondi i rindërtimit.

### **Neni 32**

#### **Shpronësimi dhe shkëmbimi**

1. Në funksion të procesit të rindërtimit, sipas parashikimeve të këtij akti, mund të zbatohen procedurat e parashikuara për shpronësimin për interes publik, sipas parashikimeve në legjislacionin në fuqi për shpronësimin për interes publik ose shkëmbimi i pasurisë së paluajtshme të palës private me një një pasuri tjetër të paluajtshme në pronësi të shtetit.
2. Kushtet dhe procedurat e përshpejtuara për shpronësimin dhe shkëmbimin parashikohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 33**

#### **Trajtimi i subjekteve në proces legalizimi**

1. Ndërtimet pa leje në zonat e planifikuara për ndërtim ose në zonat e reja për zhvillim, sipas parashikimeve të këtij akti, përjashtohen nga procedurat e legalizimit të parashikuara në legjislacionin në fuqi për legalizimin e ndërtimeve pa leje.
2. Subjektet, që posedojnë ndërtime të klasifikuara si ndërtime pa leje, në kuptim të legjislacionit në fuqi për legalizimin e ndërtimeve pa leje, në zonat e planifikuara për ndërtim, sipas këtij akti, përfitojnë në pronësi sipërfaqe ndërtimore në objektet e reja për banim, sipas kushteve dhe kritereve që përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave.

### **Neni 34**

#### **Aktekspertiza e thelluar e ndërtesave të dëmtuara**

1. Për ndërtesat që kanë pësuar dëme dhe që janë shpallur të pabanueshme nga aktkonstatimet apo aktvlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit apo grupet përkatëse të inspektimit, njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse shtetërore me qëllim garantimin e jetës dhe shëndetit, mund të kryejnë aktekspertizë të thelluar sipas procedurës të përcaktuar në këtë nen. Aktekspertiza e thelluar kryhet dhe për të gjitha ato objekte kur sipas aktkonstatimeve ose aktvlerësimeve paraprake të Institutit të Ndërtimit apo grupeve përkatëse të inspektimit, kërkohet një rivlerësim më i thelluar.
2. Aktekspertiza e thelluar përmban, përveç të tjerave, përshkrimin e hollësishëm të gjendjes së objektit, dëmet e pësuar, gjendjen strukturore, masat për riparimet dhe ndërhyrjet që duhen kryer për të garantuar sigurinë e jetës dhe të shëndetit të njerëzve si dhe vlerën financiare për këto ndërhyrje. Ekspertiza jep një konkluzion të qartë mbi gjendjen strukturore, nëse objekti mund të riparohet apo struktura e tij është dëmtuar në atë masë që dikton prishjen e detyruar të objektit.
3. Aktekspertiza e thelluar i nënshkrohet oponencës teknike nga Instituti i Ndërtimit dhe opinioni i tij mbizotëron mbi aktekspertizën e thelluar dhe zbatohet nga njësitë e vetëqeverisjes vendore ose autoritetet përgjegjëse.
4. Nëse sipas studimit të thelluar, të mbështetur dhe nga oponenca e Institutit të Ndërtimit, ndërhyrjet për riparimin e strukturës kushtojnë më shumë se 70% e kostos së rindërtimit nga e para të ndërtesës, njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës vendos shembjen e detyruar të objektit, që kryhet sipas procedurave të parashikuara në nenin 35 të këtij akti.
5. Për vlerësimin e menjëhershëm dhe në çdo rast deri në përfundim të gjendjes së fatkeqësisë natyrore, të dëmeve të ndërtesave publike ose private, njësia e vetëqeverisjes vendore ose autoriteti përgjegjës ndjek procedurën e prokurimit me negociim pa shpallje për mbulimin e nevojës emergjente, sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Procedura e prokurimit publik në këtë rast zhvillohet në formë shkresore.
6. Lejet e ndërtimit, lejet përkatëse për rikonstruksionin apo lejet e shembjes së ndërtesave, sipas parashikimeve të këtij neni, miratohen me procedura të përshpejtuara sipas parashikimeve me vendim të Këshillit të Ministrave, dhe përjashtohen nga taksa për ndikimin në infrastrukturë si dhe tarifatat e aplikimit të zbatueshme për lejet e ndërtimit.
7. Shpenzimet për aktekspertizën e thelluar, riparimin apo shembjen e objekteve të dëmtuara sipas parashikimeve të këtij neni dhe nenit 35, të këtij akti, mbulohen nga buxheti i njësisë së vetëqeverisjes vendore apo autoritetit

përgjegjës ose në rast pamundësie nga fondi i rindërtimit kur miratohet me vendim të Këshillit të Ministrave.

8. Subjektet që preken nga shembja e detyruar e ndërtesave sipas parashikimeve të këtij neni, përfitojnë nga procesi i rindërtimit sipas parashikimeve të këtij akti.

### **Neni 35** **Prishja e detyruar**

1. Prishja e detyruar e një ndërtese apo disa ndërtesave, në pronësi private apo publike, kryhet në çdo rast kur ndërtesa është dëmtuar nga fatkeqësia natyrore dhe nuk mund të riparohet ose kur përbën rrezik për jetën dhe shëndetin e njerëzve, sipas përfundimeve në aktkonstatimet apo aktvlerësimet paraprake të Institutit të Ndërtimit ose në aktekspertizën e thelluar si dhe nëse riparimi kushton më shumë se ndërtimi nga e para, sipas rekomandimeve në aktin e ekspertizës së thelluar, të hartuar sipas parashikimeve në këtë ligj.
2. Prishja e ndërtesave publike për shkaqe të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, bëhet me vendim të organit shtetëror pronar apo administrator të ndërtesës.
3. Prishja e ndërtesave, pronë private, për shkaqe të parashikuara në pikën 1, të këtij neni, bëhet me vendim të njësisë së vetëqeverisjes vendore në territorin e të cilës ndodhet ndërtesa. Njësia e vetëqeverisjes vendore vendos prishjen e ndërtesës edhe pa pëlqimin e pronarëve.
4. Autoriteti shtetëror që kryen prishjen ka detyrimin të njoftojë 24 orë përpara ndërhyrjes, Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor ku ndodhet ndërtesa si dhe strukturat e policisë vendore.

## **KREU V** **FONDI I RINDËRTIMIT**

### **Neni 36** **Fondi i rindërtimit**

1. Fondi i rindërtimit është në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit dhe konsiston në:
  - a) programin e veçantë në buxhetin e shtetit që krijohet nga të ardhura nga buxheti i shtetit dhe të ardhura nga donatorë;
  - b) dhurimet e mallrave apo shërbimeve nga donatorët, që përbëjnë kontribute në natyrë.

2. Menaxhimi, përdorimi dhe transferimi i fondeve të programit të veçantë në buxhetin e shtetit, në funksion të realizimit të programeve të procesit të rindërtimit dhe të mirëfunksionimit të fondit të rindërtimit kryhet sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për menaxhimin e sistemit buxhetor dhe ligjit përkatës për buxhetin vjetor.
3. Për vlerësimin ekonomik, marrjen në dorëzim, rregullat dhe procedurat për magazinim dhe përdorimin e kontributeve në natyrë zbatohen parashikimet e këtij akti.
4. Njësitë e vetëqeverisjes vendore, sipas mundësive, kontribuojnë në procesin e rindërtimit me burimet e veta materiale dhe financiare.

### **Neni 37** **Kontributet në natyrë**

1. Në rastet kur donatorët marrin përsipër të kontribuojnë në natyrë, sende apo materiale ndërtimore, punë apo shërbime në funksion të procesit të rindërtimit, këto kontribute merren në dorëzim nga Agjencia Kombëtare e Mbrojtjes Civile, që bashkëpunon për këtë qëllim me Drejtorinë e Përgjithshme të Rezervave Materiale të Shtetit ose me kërkesë të kësaj Drejtorie me njësitë e vetëqeverisjes vendore dhe i vendosen në dispozicion njësisë zbatuese sipas parashikimeve të këtij akti.
2. Kontributet në natyrë të prodhuara, të projektuara apo të përshtatura për ndërtim ose rikonstruksion përlllogariten në vlerën e tyre financiare dhe i vendosen në dispozicion kontraktorit të përzgjedhur për zbatimin e punimeve me kusht që vlera korresponduese e tyre t'i zbritet kostos së preventivit të projektit që do të zbatohet. Përdorimi i kontributeve në natyrë në procesin e rindërtimit vendoset me vendim të Këshillit të Ministrave.
3. Kontributet në natyrë, sende apo materiale ndërtimore magazinohen dhe inventarizohen nga autoriteti përgjegjës dhe lëvrimi i tyre bëhet me kërkesë të njësisë zbatuese dhe me miratim paraprak të Komisionit Shtetëror të Rindërtimit.
4. Pas magazinimit, autoriteti përgjegjës për magazinimin lëshon një vërtetim ku përcaktohet emri i subjektit, përshkrimi i sendeve të dhuruara, sasia e tyre, si dhe data e vendi i depozitimit.
5. Çmimet e inventarizimit të tyre përcaktohen nga vetë autoriteti përgjegjës për magazinimin duke u bazuar në çmimet e shitjes kur këto dhurohen me faturë, në çmimet referuese të doganave kur nuk kanë një faturë ose në çmimet referuese sipas manualeve të ndërtimit në fuqi.

6. Për kontributet në vlerë pune, vlera e punës ose e shërbimit përlllogaritet sipas pagës mesatare të gjashtë muajve të fundit për të njëjtën punë për punonjësit e subjektit kontribues.
7. Në rastet e kontributit në shërbime, vlera e shërbimit përlllogaritet sipas kostos mesatare të gjashtë muajve të fundit për të njëjtin shërbim të ofruar nga kontribuesi.
8. AKMC-ja informon Komisionin Shtetëror të Rindërtimit për çdo kontribut në natyrë që regjistrohet sipas parashikimeve të këtij neni.
9. Kontributet sipas këtij neni u njihen subjekteve përkatëse si shpenzime të zbritshme mbi tatimfitimin.
10. Të gjitha kontributet në natyrë, sipas përcaktimeve në këtë nen, publikohen në portalin e transparencës së procesit të rindërtimit.
11. Metodologjia për përcaktimin e vlerës së kontributeve në natyrë, sendeve apo materialeve ndërtimore si dhe kushtet e procedura për njohjen e kontributit si shpenzim i zbritshëm miratohen me udhëzim të përbashkët të ministrit të Financave dhe Ekonomisë dhe ministrit të Mbrojtjes.

### **Neni 38** **Transparenca**

1. Në funksion të transparencës të përdorimit të fondeve të procesit të rindërtimit krijohet portali unik qeveritar.
2. Portali unik qeveritar publikon informacione ku përfshihen, por nuk kufizohet vetëm në:
  - a) programin kombëtar të rindërtimit;
  - b) të dhëna mbi fondin e rindërtimit, burimin e krijimit të tij, kontributet në para dhe kontributet në natyrë dhe mënyrën e shpenzimit të këtij fondi;
  - c) projektet e realizuara;
  - ç) zonat e zhvilluara dhe zonat në zhvillim;
  - d) vendimet e autoriteteve përgjegjëse;
  - dh) të dhëna mbi procedurat e prokurimit në funksion të procesit të rindërtimit.
3. Në publikimin e informacionit përdoren, për aq sa është e mundur, parimet e *Open Data*.

### **Neni 39** **Auditimi**

1. Përveç sa është parashikuar në legjislacionin në fuqi për ushtrimin e veprimtarisë së auditimit në sektorin publik, fondi i rindërtimit si dhe çdo autoritet tjetër, publik ose privat, që përdor fonde buxhetore nga fondi i rindërtimit i nënshtrohen edhe auditimit ligjor, sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor.
2. Audituesit, që angazhohen në auditimet ose procedurat e përcaktuara në këtë nen, nuk duhet të jenë subjekt i masave disiplinore apo në proces hetimi disiplinor për shkelje të legjislacionit në fuqi për auditimin ligjor si dhe duhet të jenë vlerësuar me notën A, B ose C, përgjatë kontrollit të cilësisë së punës së tyre në tri vitet e fundit, nëse një kontroll i till është kryer.
3. Fondi i rindërtimit konsiderohet me interes publik dhe çdo angazhim auditimi ligjor konsiderohet si angazhim auditimi ligjor i një njësie me interes publik dhe i nënshtrohet detyrimeve ligjore, sipas përcaktimeve të ligjit përkatës për auditimin ligjor. Përfshihen nga parashikimet e këtij neni fondet që dhurohen nga donatorët dhe që shpenzohen drejtpërdrejt prej tyre në funksion të procesit të rindërtimit sipas parashikimeve të këtij akti.

## **KREU VI PROCEDURAT E PROKURIMIT PUBLIK**

### **Neni 40 Objekti**

1. Objekt i këtij kreu është përcaktimi i rregullave të posaçme që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga njësitë zbatuese në funksion të procesit të rindërtimit, përveç rasteve kur në këtë akt parashikohet ndryshe.
2. Përfshihen nga zbatimi i këtij kreu prokurimi i punëve ose shërbimeve të lidhura me rindërtimin ose riparimin e monumenteve të trashëgimisë kulturore, të dëmtuara nga fatkeqësitë natyrore, për të cilat zbatohen parashikimet e legjislacionit në fuqi për trashëgiminë kulturore.

### **Neni 41 Parimet e prokurimit publik për rindërtimin**

1. Prokurimi publik për rindërtimin siguron:
  - a) mirëpërdorimin e fondit të rindërtimit dhe uljen e shpenzimeve procedurale;
  - b) nxitjen e pjesëmarrjes së operatorëve ekonomikë;
  - c) trajtimin e barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë;

- ç) integritetin, besimin publik dhe transparencën.
2. Parimet e parashikuara në pikën 1, të këtij neni, rekomandohen të zbatohen edhe nga donatorët gjatë procedurave të përzgjedhjes së kontraktorëve që kryejnë projektimin, zbatimin dhe mbikëqyrjen e punimeve të ndërtimit në funksion të procesit të rindërtimit.
  3. Përzgjedhja e fituesve, që zbatojnë kontratat publike në kuadër të procesit të rindërtimit, kryhet sipas kriterëve të vlerësimit në lidhje me objektin e kontratës që prokurohet dhe janë cilësia, çmimi dhe koha e zbatimit të kontratës.

## **Neni 42**

### **Procedura e prokurimit publik për rindërtimin**

1. Kriteret e kualifikimit dhe kriteret e vlerësimit hartohen sipas legjislacionit për prokurimin publik, për aq sa është e mundur dhe pa rënë ndesh me parashikimet e këtij akti.
2. Këshilli i Ministrave miraton autoritetin përgjegjës për zhvillimin e procedurës, dokumentet standarde të procedurës së prokurimit, kriteret e vlerësimit dhe përcaktimit të ofertës fituese, kushtet e marrëveshjes kuadër si dhe të kontratës.
3. Autoriteti përgjegjës skualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik, nëse është ose ka qenë i dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë, për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:
  - a) pjesëmarrje në grup të strukturuar kriminal, organizatë kriminale, bandë të armatosur, organizatë terroriste;
  - b) korrupsion;
  - c) mashtrim;
  - ç) pastrim parash ose financim i terrorizmit;
  - d) vepra me qëllime terroriste ose vepra penale të lidhura me veprimtari terroriste;
  - dh) organizim, drejtim ose financim i veprimtarisë së prodhimit dhe shitjes së narkotikëve, si dhe i veprimtarisë së trafikimit të narkotikëve;
  - e) falsifikim;
  - ë) shfrytëzim i punës të të miturve dhe forma të tjera të trafikimit të qenieve njerëzore.
4. Detyrimi për të shkualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur personi i dënuar me një vendim gjyqësor të formës së prerë është anëtar i një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i atij, aksionar ose ortak,

operator ekonomik ose ka kompetenca përfaqësuese, vendimmarrjeje ose kontrolluese brenda tij.

5. Autoriteti përgjegjës shkualifikon nga procedura e përzgjedhjes së fituesve të kontratave publike çdo operator ekonomik në rastet kur:
  - a) ka falimentuar dhe kapitalet e tij janë në proces ekzekutimi nga përmbaruesit;
  - b) është subjekt i procedurave për deklarimin e falimentimit dhe ka një urdhër likuidimi të detyruar ose administrimi nga gjykata, ose ka një marrëveshje me kreditorët, ose ndonjë procedurë tjetër të ngjashme;
  - c) është dënuar me vendim gjykate të formës së prerë për vepra që lidhen me veprimtarinë profesionale;
  - ç) nuk i ka përmbushur detyrimet për derdhjen e kontributeve të sigurimeve shoqërore, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
  - d) nuk i ka përmbushur detyrimet për pagimin e tatimeve, në përputhje me legjislacionin shqiptar ose me dispozitat e zbatueshme në shtetin e origjinës;
  - dh) është fajtor për dhënie të informacioneve të rreme, kur këto i janë kërkuar në përputhje me këtë kre, ose nuk ka pranuar t'i japë këto informacione ose dokumente apo një pjesë të tyre;
  - e) me vendim të Agjencisë së Prokurimit Publik është përjashtuar nga pjesëmarrja në procedurat e prokurimit publik dhe/ose koncesioneve ;
  - ë) ndërtime civile (godina banimi ose ndërtesa të tjera shtetërore) dhe industriale të projektuara, të ndërtuara, të mbikëqyrura dhe/ose të kolauduara, ku ofertuesi është shfaqur në cilësinë e kontraktorit, nënkontraktorit, janë dëmtuar nga ngjarja e fatkeqësisë natyrore dhe kur ky dëmtim ka ardhur si pasojë e cilësisë së shërbimit dhe/ose zbatimit të punimeve të operatorit ekonomik, vërtetuar nga organet kompetente. Detyrimi për të shkualifikuar një operator ekonomik zbatohet edhe kur aksionari, ortaku, administratori dhe/ose anëtarët e një organi administrativ, drejtues ose mbikëqyrës i tij, aksionar ose ortak ka pasur kompetenca vendimmarrëse në një shoqëri e cila ndodhet në kushtet e mësipërme.
6. Njësia zbatuese përdor procedurën e përshpejtuar, sipas përcaktimeve të këtij akti, për përzgjedhjen e fituesve të marrëveshjes kuadër për procesin e rindërtimit. Në çdo rast, konkurrimi për marrëveshjen kuadër bëhet me detyrimin për paraqitjen e kapaciteteve teknike, ligjore, ekonomike me ose pa detyrimin për paraqitjen e ofertës financiare.
7. Njësia zbatuese publikon në sistemin e prokurimit elektronik, Buletinin e Njoftimeve dhe në portalin unik të procesit të rindërtimit, njoftimin e kontratës dhe dokumentet e tenderit për çdo procedurë prokurimi që

zhvillohet në kuadër të këtij akti, me përjashtim kur në këtë akt parashikohet ndryshe.

8. Dokumentacioni dorëzohet në sistemin e prokurimeve elektronike. Afati kohor për pranimin e dokumentacionit është 10 ditë kalendarike nga data e publikimit të njoftimit.
9. Në rastin e ankesave për dokumentat e tenderit operatorët ekonomikë ankohen brenda 2 ditëve nga publikimi i dokumenteve të tenderit në Komisionin e Prokurimit Publik (KPP), që shqyrton ankesën dhe merr vendim brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe këtij akti. Me kalimin e këtij afati, nëse KPP-ja nuk është shprehur me vendim, autoriteti kontraktor vijon procedurën e prokurimit.
10. Pas afatit për paraqitjen e kërkesave për pjesëmarrje, siç përcaktohet në njoftimin e kontratës, autoriteti kontraktor përzgjedh kandidatët brenda 10 ditëve kalendarike. Kundër vendimit të autoritetit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve paraqitet ankim administrativ pranë KPP-së, brenda 3 ditëve nga njoftimi i kandidatëve fitues. KPP-ja shqyrton ankesën dhe merr vendim brenda 5 ditëve nga data e depozitimit të ankesës, në përputhje me parashikimet e Kodit të Procedurave Administrative dhe të këtij akti. Për efekt kohe, komunikimi midis Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor bëhet nëpërmjet *e-mail*-it zyrtar. Me kalimin e këtij afati, nëse KPP-ja nuk është shprehur me vendim, autoriteti kontraktor vijon me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
11. Ankesa në Komisionin e Prokurimit Publik bëhet kundrejt pagesës, sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për prokurimin publik.
12. Kundër vendimit të KPP-së mund të paraqitet ankim në gjykatën administrative kompetente sipas parashikimeve të legjislacionit në fuqi për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative. Ankimi në gjykatë nuk pezullon vijimin e procedurës së prokurimit dhe lidhjes së kontratës publike.

### **Neni 43**

#### **Lidhja e kontratave pas marrëveshjes kuadër**

1. Autoriteti kontraktor përgatit ftesën për ofertë dhe ia dërgon vetëm operatorëve ekonomikë, palë të marrëveshjes kuadër.
2. Ftesa për ofertë drejtuar operatorëve ekonomikë përcakton afatin kohor për dorëzimin e ofertave, e cila nuk mund të jetë më e gjatë se 10 ditë kalendarike, kriteret e përcaktimit të ofertës fituese për kontratën e bazuar në

marrëveshjen kuadër dhe çdo informacion të nevojshëm për përgatitjen e ofertave.

3. Autoriteti kontraktor, jo më vonë se 5 ditë nga data e marrjes së ofertave, përzgjedh ofertën fituese.
4. Menjëherë, por në çdo rast jo më vonë se 5 ditë pas shpalljes së ofertës fituese, autoriteti kontraktor fton operatorin fitues të lidhë kontratën. Përpara nënshkrimit të kontratës, operatori ekonomik fitues duhet t'i dorëzojë autoritetit kontraktor një sigurim kontrate prej 15% të vlerës së saj. Sigurimi i kontratës ka formën e një depozite apo garancie, të lëshuar nga një bankë e nivelit të dytë ose një shoqëri sigurimi, e licencuar nga autoritetet shtetërore për të ushtruar këtë veprimtari.

#### **Neni 44**

#### **Procedura prokurimit në kushtet e emergjencës**

Për nevoja emergjente në verifikimin e dëmeve, lidhjen e kontratave të konsulencës, blerjen e pajisjeve të rëndësisë parësore për gjendjen e krijuar dhe përjashtimisht në rastet e pamundësisë së përdorimit të procedurave të parashikuara në këtë ligj, me qëllim përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore autoritetet përgjegjëse shtetërore përdorin procedurën e prokurimit me negociim pa shpallje sipas legjislacionit në fuqi për prokurimin publik. Procedura e prokurimit publik në këtë rast zhvillohet në formë shkresore.

### **KREU VII**

### **KUALIFIKIMET PROFESIONALE**

#### **Neni 45**

#### **Njohja e kualifikimeve profesionale**

1. Shtetasit shqiptarë, të cilët kanë njohuri të natyrës profesionale ose teknike në fushën e arkitekturës, inxhinierisë, gjeodezisë, ose profesioneve të tjera të nevojshme në procesin e rindërtimit, të cilët kanë bërë kërkesë dhe janë në proces për marrjen e licencës, të lejes, autorizimit ose certifikatës për ushtrimin e aktivitetit, do të jenë subjekt i një procedure të përshpejtuar shqyrtimi dhe vendimmarrje nga autoritetet shtetërore përgjegjëse.
2. Qendra Kombëtare e Biznesit (QKB) ose autoriteti kompetent merr masa të kryejë procedurën e përshpejtuar të shqyrtimit dhe të vendimmarrjes për pajisjen me licencë, autorizim, leje ose certifikatë, sipas këtij neni, brenda 10 ditëve nga hyrja në fuqi e këtij akti ose nga momenti i aplikimit.

#### **Neni 46**

#### **Njohja e kualifikimeve profesionale të subjekteve të huaja**

1. Personat fizikë dhe juridikë të huaj, të cilët kanë njohuri të natyrës profesionale ose teknike në fushën e arkitekturës, inxhinierisë, gjeodezisë ose profesioneve të tjera të nevojshme në procesin e rindërtimit i nënshtrohen procedurës së përshpejtuar për t'u pajisur me licencë, leje, autorizim ose certifikatë të lëshuar nga QKB-ja ose autoriteti kompetent, sipas legjislacionit në fuqi për licencat, nëse zotërojnë licencimin ose certifikimin e kualifikimeve profesionale, në përputhje me legjislacionin e vendit të huaj ku ushtrojnë veprimtarinë profesionale. Në këtë rast, QKB-ja ose autoriteti kompetent merr masa që të kryejë procedurën e përshpejtuar të njohjes dhe njësimit të lejes, licencave ose autorizimeve përkatëse, brenda 10 ditëve nga data e aplikimit, së bashku me dokumentacionin shoqërues.
2. Njohja e licencave dhe/ose e kualifikimeve profesionale, sipas këtij neni, përjashton shtetasin e huaj nga detyrimi për anëtarësim të detyrueshëm në shoqatat ose urdhrat profesionalë deri në përfundim të periudhës së zhvillimit të procesit të rindërtimit nga gjendja e fatkeqësisë natyrore.
3. Njohja e licencave dhe/ose kualifikimeve profesionale, sipas këtij neni, mbetet e vlefshme deri në përfundim të periudhës së zhvillimit të procesit të rindërtimit nga gjendja e fatkeqësisë.

## **KREU VIII PËRJASHTIME FISKALE DHE LEHTËSIRA**

### **Neni 47 Përjashtimet fiskale**

Përjashtimet nga taksat dhe tatimet, tarifat e aplikimit për shërbime në administratën shtetërore, në kuadër të procesit të rindërtimit parashikohen në këtë akt dhe në legjislacionin e posaçëm për përjashtimet fiskale gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

### **Neni 48 Lehtësira**

1. Autoritetet përgjegjëse, të përcaktuara në këtë akt, bashkëpunojnë me autoritetet dhe entet përkatëse publike që individët dhe familjet që kanë humbur familjarët dhe/ose kanë mbetur të pastrehë nga fatkeqësia natyrore, të përfitojnë lehtësira për pagesat e konsumit të ujit dhe të energjisë elektrike gjatë gjendjes së fatkeqësisë natyrore.
2. Autoritetet përgjegjëse, të përcaktuara në këtë akt, bashkëpunojnë me sektorin bankar për aq sa është e mundur, që individët dhe familjet që kanë humbur familjarët dhe/ose kanë mbetur të pastrehë dhe/ose të papunë nga fatkeqësia natyrore, të cilët janë palë huamarrëse në kontrata të kredive

bankare të lehtësohen nëpërmjet ristrukturimit të afateve, të kushteve dhe të termave të kredive gjatë periudhës së gjendjes së fatkeqësisë natyrore.

**Neni 49**  
**Hyrja në fuqi**

Ky akt normativ hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në “Fletoren zyrtare”.

**K R Y E M I N I S T R I**

**EDI RAMA**

MINISTRI I BRENSHËM

SANDËR LLESHAJ

MINISTRI I MBROJTJES

OLTA XHAÇKA

MINISTRI FINANCAVE  
DHE EKONOMISË

ANILA DENAJ

MINISTRI I DREJTËSISË

ETILDA GJONAJ